

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda**, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Beqir Kalludra, kryetar, dhe gjyqtarët profesionistë Elife Uka dhe Arben Hoti, anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit Arianit Mahmutaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.B, për shkak të veprës penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par. 3 lidhur me par. 1 të KPK-së, sipas aktakuzës së ndryshuar të Prokurorisë së shtetit, PP.nr.74/05 të dt.17.03.2005, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, me dt.15.09.2016, në të cilën kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Ilaz Beqiri, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, sipas detyrës zyrtare, av.M.H, të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht këtë:

### A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit N.B, i biri A dhe Xh, i vajzësirë B, i lindur më *data e lindjes* në fshatin R, komuna e L, ku edhe jeton, i pa punë, bujk, i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, deri më tani i pa gjykuar dhe ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, në paraburgim ka qëndruar nga dt. 22.02.2005 deri me dt.30.03.2005.

Konform nenit 363 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nënpar.1.3 të KPPRK-së,

**Refuzohet Akuza** për veprën penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së, për shkak të tërheqjes së prokurorit të shtetit nga akuza, gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate, në bazë të nenit 454 par.1 të KPRK-së.

I dëmtuari L.B nuk ka paraqitur propozim për kërkesë pasurore-juridike.

### A r s y e t i m

Prokuroria Publike atëherë e Qarkut në Prishtinë, kundër të akuzuarit N.B ka paraqitur aktakuzë PPnr.74-2005 të dt.17.03.2005, për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar, se i njejtë ka kryer veprën penale Vrasje në tentativë, nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar disa seanca të shqyrtimit gjyqësor, dhe në seancën e fundit të shqyrtimit gjyqësor të dt.15.09.2016, pas administrimit të të gjitha provave dhe dëgjimit të të akuzuarit, prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka bërë ricilësimin juridik të veprimeve inkriminuese të të akuzuarit, dhe ate, nga cilësimi juridik i veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, në veprën penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par. 3 lidhur me par.1 të KPK-së, dhe pas ricilësimit të kësaj vepre penale, prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza, për faktin se tani më, për veprën e ricilësuar penale, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale, duke pas për bazë faktin se lartësia e

dënimit me burgim për këtë vepër penale është paraparë më së shumti deri në 5 vjet, derisa parashkrimi absolut për këtë vepër penale arrin brenda periudhës kohore prej 10 vitesh, konform nenit 90 par. 4 lidhur me nenin 91 par. 6 të KPPK-ës, pasi që, nga koha e kryerjes së kësaj vepr penale, pra më datë 20.05.2005, e deri më tani, kanë kaluar më tepër se 10 vjet.

Andaj bazuar në një gjendje të tillë të fakteve, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për refuzimin e akuzës kundër të akuzuarit N.B, konform nenit 363 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nënpar.1.3 të KPPRK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale është marrë, duke pas për bazë faktin se kundër të akuzuarit është refuzuar akuza, konform nenit 454 par.1 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marrë konform nenit 461 par.1 të KPPRK-së, kjo për faktin se përfaqësuesi ligjor - vëllai i të dëmtuarit tani të ndjerit S.B, L.B, nuk ka paraqit propozim për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 363 par.1 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

Departamenti për Krime të Rënda

P.nr.150/05, dt.15.09.2016

**Procesmbajtësi**  
Arianit Mahmutaj

**Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari**  
Beqir Kalludra

### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve  
nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.